



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 559/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit Internet Caffë “L...”, me NUI ..., me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Xhevdet Krasniqi, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me energji Elektrike Sh.a.-KEDS, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.073/2020 të datës 04.06.2020 të Përbaruesit Privat Kushtrim Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 12.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me energji Elektrike Sh.a.- KEDS, me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër urdhrit përbarimor P.nr.073/2020 të datës 04.06.2020, të Përbaruesit Privat Kushtrim Metaj.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr. 073/2020 i datës 04.06.2020, i lejuar nga Përbaruesi Privat Kushtrim Metaj në Prishtinë.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat Kushtrim Metaj, duke vepruar sipas propozimit të të autorizuarit të kreditorit Internet Caffë “L...”, me seli në Prishtinë, në bazë të titullit ekzekutiv - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.nr.516/2017 i datës 04.12.2018 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ae.nr 32/19 i datës 03.03.2020, ka nxjerr urdhrin P.nr. 073/2020 me datën 04.06.2020, me të cilin ka caktuar zbatimin e përbarimit, ndaj

debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me energji Elektrike Sh.a.-KEDS, me seli në Prishtinë, duke e detyruar debitorin që në emër të kompensimit të dëmit, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 1,082.98 € (një mijë e tetëdhjetë e dy euro e nëntëdhjetë e tetë cent), me kamatë vjetore prej 8% në vit, duke filluar prej datës 08.11.2017, e deri në pagesën definitive, gjithashtu shumën prej 708.90 € (shtatëqind e tetë euro e nëntëdhjetë cent), në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, shumën prej 156.00 € (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro) në emër të përpilimit të Propozimit për Ekzekutim si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore sipas tarifës së përbaruesit privat, në xhirollogarinë bankare N.1...., të të autorizuarit Av. Xhevdet Krasniqi.

Debitori përmes të autorizuarit të tij, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se urdhri për përbarim është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, pasi që me rastin e dorëzimit të propozimit për përbarim janë shkelur dispozitat e LPP-së 04/L-139, pasi që dokumenti në bazë të të cilit është marrë vendimi përbarues ose urdhri përbarimor, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përbarueshmërisë, duke kundërshtuar në tërësi propozimin për përbarim meqenëse urdhëri përbarues është lëshuar pas aktgjykimit IV.EK.nr.516/17 i datës 01.12.2018, i cili ka marrë formën e prerë me vendimin e ekzekutueshëm të datës 03.03.2020. Ka shtuar në rastin konkret nuk është bërë vlerësimi dhe sigurimi i provave në vendin e ngjarjes duke mos konstatuar se pajisjet janë djegur tërësisht apo pjesërisht dhe se këto pajisje a kanë mundur të rregullohen. Ka kërkuar nga gjykata që të caktoj seancë publike për ta kuptuar validitetin dhe domethënien e prapësimi sipas nenit 73 të LPP-së, ndërsa në fund i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të aprovohet si i bazuar dhe urdhri përbarimor të anulohet si i pabazuar dhe kreditori ti bart shpenzimet përbarimore.

Përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit, në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe se të njëjtat janë të pabazuara, duke shtuar se aktgjykimi i shkallës së parë në mënyrë të qartë e ka miratuar kërkesëpadinë dhe e ka obliguar të paditurën KEDS që të paguaj kompensimin dhe shpenzimet e procedurës, ku gjithashtu edhe Gjykata e Apelit e ka vërtetuar si të drejtë dhe të ligjshëm, si gjykatë e shkallës së dytë, gjithashtu sa i përket mos sigurimit të provës në vendin e ngjarjes dhe mos konstatimi i saktë se cilat pajisje janë djegur apo a mund të rregullohen, është vetëm sa për të neglizhuar procesin pasi tani në procedurën përbarimore nuk mund të paraqiten

këto prova. Pretendimet për caktimin e një seance gjyqësore të hapur gjithashtu nuk qëndrojnë pasi që urdhri përmbartimor është lejuar në bazë të dokumentit ekzekutiv me të gjitha tiparet e përmbartimshëmrisë dhe gjykatës i ka propozuar që të refuzoj prapësimin e debitorit dhe ta vërtetoj urdhrin P.nr 73/2020 të datës 04.06.2020, duke i kërkuar edhe shpenzimet për përgjigje në prapësim në shumën prej 156.00 € (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro).

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim si dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, nga fakti se debitori nuk ka ofruar asnjë provë me shkrim konform nenit 69 paragrafi 4 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore (tutje LPP), me të cilën do të mund të kërkonte anulimin e këtij vendimi, sipas kushteve të parapara me nenin 71 të LPP-së.

Gjykata erdhi në përfundim se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për faktin se në prapësimin e debitorit nuk janë dhënë arsye që prapësimi të pranohet si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbartimor, ndërsa e ka lënë në fuqi Urdhrin e Përmbartuesit Privat P.nr 073/2020 të datës 06.04.2020, pasi që i njëjti është lejuar në bazë të dokumentit përmbartues (titullit ekzekutiv) - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.nr.516/17 i datës 04.12.2018 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ae.nr.32/19 dt. 03.03.2020.

Sipas dokumentit përmbartues (titullit ekzekutiv) - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.nr.516/2017 i datës 04.12.2018, debitori është detyruar që kreditorit në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar, t'ia paguaj shumën prej 1.089,98 € (një mijë e tetëdhjetë e dy euro e nëntëdhjetë e tetë cent), me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën defintive, si dhe për shpenzimet e procedurës kontestimore prej 708.00 € (shtatëqind e tetë euro e nëntëdhjetë cent), në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ae.nr.32/19 e datës 03.03.2020.

Gjykata gjeti se dokumenti përmbartimor – Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike IV Ek.nr. 516/2017 i datës 04.12.2018, është dorëzuar në origjinal dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili përcakton se:

*“Propozimi për përmbardim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbardim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbardimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbardimi, kërkuesi i përmbardimit dhe debitori, adresa e vendbanimit–vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbardimi, objekti i përmbardimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbardimit”.*

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbardues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbardimin vetëm në bazë të dokumentit përmbardues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.1, përcaktohen dokumentet përmbarduese siç janë: *“vendimi përmbardues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbarduese;”*, ndërsa me nenin 23. par.1 përcaktohet se *“ vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit.”*, dhe nenin 24 par. 1 përcaktohet të LPP-së përcaktohet se: *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i pambarueshëm po qe se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”*, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbardimor është i përshtatshëm për përmbardim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”.*

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se urdhri për përmbardim i caktuar mbi bazën e titullit ekzekutiv – Aktgjykimit i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përmbardues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbardimit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.1, nenit 23 par.1, nenit 24 par. 1 dhe nenit 27 të LPP-së, pasi që Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, VI.Ek.nr. 516/2017 i datës 04.12.2018, është i përmbardueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbardim, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitori, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorit se në këtë rast është obliguar vetë KEDS që ti paguaj shpenzimet e veta procedurale dhe gjeti se pretendimi i tillë i debitorit është i pa bazuar, pasi që në shkresa të lëndës rezultoi se në mënyrë të qartë Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë e ka obliguar që t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kreditorit, ku po të njëjtën vendim e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit si të ligjshëm dhe të drejtë.

Gjykata po ashtu gjeti se është i pa bazuar pretendimi i debitorit “*se në rastin konkret nuk është bërë sigurimi i provës në vendin e ngjarjes si dhe nuk është konstatuar se cilat pajisje janë djegur dhe të njëjtat a mund të rregullohen*”, pasi që nga shkresat e lëndës rezultoi se këto pretendime janë paraqitur në dy instanca gjyqësore, kurse nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbartimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 5 par.5 dhe 73 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE - Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.559/22 dt.12.09.2022

Gjyqtarja

Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të aktvendimit, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, Dhomat e Shkallës së Dytë.